REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E PROKURORËVE
KOMISIONI I VOTIMIT

Tiranë, më 28.01.2021

PROCESVERBAL

I PROCESIT TË VOTIMIT NGA MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E PROKURORËVE PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE PROKUROR TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Sot, më 28.01.2021, ora 11.23, në Tiranë, mbahet ky procesverbal për të dokumentuar votimin nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve prokuror për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 115, pika 3 të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve në përputhje me rendin e ditës, votoi për zgjedhjen e 1 (një) prokurori pranë gjykatave të shkallës së parë si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe 1 (një) prokurori pranë gjykatave apelit si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Nga lista emërore e nënshkruar vërtetohet se morën pjesë në mbledhje 257 (dyqind e pesëdhjetëeshtatë) prokurorë të të gjithë niveleve.

Votimi nisi në orën 11.23 dhe përfundoi në orën 14.06

U hap kutia e votimit, për kandidatët prokuror të prokurorive të shkallëve të para duke verifikuar kodet e administruara nga komisioni i votimit dhe rezultoi se përputhen me kodet e vendosura para fillimit të votimit.
Nga adminsistrata ishin përgatitur 275 fletë votimi.

Nga numërimi rezultoi se numri total i votave të hedhura në kuti është 257 (dyqind e pesëdhjetëeshtatë). Ngelen 18 fletë votimi te papërdorura.
Nga numri total i votave, rezultoi se 249 (dyqindëdyzetenëntë) fletë votimi janë të vlefshme dhe 8 (tetë) fletë votimi janë të pavlefshme.

Nga numërimi i votave të vlefshme, të lexuara e shfaqura për gjithë të pranishmit, rezulton të jetë votuar për kandidatët, si vijon:

- Z. Albert Kuliçi, 45 vota;
- Znj. Eloida Goxhi, 104 vota;
- Znj. Elona Alvora, 9 vota;
- Z .Zeqir Hoda, 91 vota;

Në përputhje me nenin 115/5 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", shpallet fitues, për prokurorit e shkallës së parë kandidati me numrin më të madh të votive, e cila është Eloida Goxhi.

U hap kutia e votimit, për kandidatët prokuror të prokurorive të apeleve duke verifikuar kodet e administruara nga komisioni i votimit dhe rezultoi se përputhen me kodet e vendosura para fillimit të votimit.

Nga numërimi rezuloti se numri total i votave të hedhura në kuti është 257 (dyqind e pesedhjete e shtate). Nga numri total i votave, rezultoi se 238 (dyqindë e tridhjetë e tetë) vota janë të vlefshme dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) vota janë të pavlefshme.

Nga numërimi i votave të vlefshme, të lexuara e shfaqura për gjithë të pranishmit, rezulton të jetë votuar për kandidatët, si vijon:

- Z. Moisi Duda , 238 vota;

Në përputhje me nenin 115/5 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", shpallet fitues, për prokurorit e Apelit kandidati Moisi Duda.

Proceverbali mbahet në 2 (dy) kopje, u lexua e u gjet i rregullt dhe firmoset pa vërejtje nga Komisioni i Votimit.

Procesverbali, vendimi dhe gjithë materialet e votimit i dorëzohen Prokurorit të Përgjithshëm, sot në datë 28.01.2021.

Procesverbali mbyllet në orën 15.20.

KOMISIONI I VOTIMIT

ANËTAR	KRYETAR	ANËTAR
ANILA LEKA	ADNAN XHOLI	ALFRED PROGONATI